ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PODUJEVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **615-22-363-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i shkollës në fshatin Obrançë**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

____ ARAD 94 SH.P.K. ____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

_____ Rr. "28 Nëntori", Su-1/5, H.4, nr.4_____
(Adresa)

_____ PRISHTINË _____ **_____10000_____**
(Vendi) *(Kodi postar)*

_____ 044 444 328_____ **_____**
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

_____ Ardit Hoxha_____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____ arad-94@hotmail.com_____
(Adresa elektronike)

_____20.05.2022_____ **_____**
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **"Ndërtimi i shkollës në fshatin Obrançë"**

Njoftimi për kontratë është bërë me datën 31.01.2022 dhe hapja publike është bërë me datën 21.02.2022.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar më 27.04.2022.

Të pakënaqur me këtë vendim iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim në datën 04.05.2022.

Përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me datë 10.05.2022 me të cilën nuk pajtohemi andaj në afat të rregullte kohorë po iu drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

Kriteri i vlerësimit ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒ **X**

Hapja publike është bërë më datën 21.02.2022. Gjate hapjes publike nuk u evidentua ndonjë vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar më 27.04.2022. Të pakënaqur me këtë vendim iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim me datën 04.05.2022. Përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim si refuzim e kemi pranuar me datë 10.05.2022 me të cilën nuk pajtohemi andaj në afat të rregullte kohorë po iu drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. **AK ka shkelur Nenin 6 të LPP-së Nr. 04/L-042,**
2. **AK ka shkelur Nenin 7 të LPP-së Nr. 04/L-042,**
3. **AK ka shkelur Nenin 24 të LPP-së Nr. 04/L-042,**
4. **AK ka shkelur Nenin 52 të LPP-së Nr. 04/L-042,**
5. **AK ka shkelur Nenin 59 të LPP-së Nr. 04/L-042,**
6. **AK ka shkelur Nenin 39 të RRUOPP-së**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit në përgjithësi, nuk kanë luajtur rol aktiv për t'u siguruar se fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë **efikase** dhe **ekonomike**. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara me Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit për këtë procedurë. Më saktësisht AK pa të drejt ka shpërblyer me kontratë një OE i cili nuk i plotëson kriteret dhe kërkesat e dosjes së tenderit. Mos aplikimi i kërkesave të parapara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit e shtynë AK-në jo vetëm drejt shkeljes së nenit 6 të LPP-së por edhe drejt shkeljes së neneve tjera të LPP-së sepse me këtë veprim po tenton të ja besoj kontratën e tillë OE i cili nuk është i përgjegjshëm dhe nuk i plotëson një mori të kushteve të parapara nga vet AK-ja.

Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet se AK ka shkelur nenin 6 të LPP-së duke mos vlerësuar në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat e neneve të cekura në pretendimet tona.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. E themi këtë sepse edhe përkundër shumë mangësive të theksuara në ofertën e tij, OE i shpallur fitues favorizohet dhe shpërblehet me kontratë..

Vlen të theksohet se OE i shpallur fitues nuk posedon dëshmi të rregullta lidhur me dëshmitë e ofruar për stafin e kërkuar, mjetet, stabilimentet dhe pajisjet e ofruara nuk e ka dorëzuar sigurimin e tenderit me validitet sipas kërkesës si dhe nuk ka fare specifikim teknik ose deklaratë mbi plotësimin e specifikimeve teknike të parapara nga AK. Këto dokumente shihen qartë se janë jo të rregullta dhe disa nga to edhe dyshohet se janë të manipuluara prandaj trajtimi i tyre si të rregullta nga ana e AK-së konsiderohet **favorizim** i plotë ndaj këtij OE. Kjo nuk është vetëm favorizim por në një formë është edhe bashkëpunim në manipulim me OE në fjalë që nuk është i përgjegjshëm ku në të njëjtën kohë i lejohet edhe të plotësoj tenderin me dëshmi shtesë, të modifikuara nga vet OE në emër të punëtorëve. Kjo nuk lejohet me asnjë nga dispozitat ligjore që flasin për vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit andaj shihet hapur se AK ka favorizuar këtë OE.
Detajet e mangësive në ofertën e këtij OE do ti shpalosim detalisht në pretendimin 5 ku do ta argumentojmë edhe gabimin dhe shkeljen e AK-së me rastin e shpalljes fitues të një OE të papërgjegjshëm.

Bazuar në këtë lirisht mund të themi se AK gjatë procesit të vlerësimit ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit mbi trajtimin e drejtë, favorizimin dhe në të njëjtën kohë edhe diskriminimin e tenderuesve.

Pretendimi 3: AK ka shkelur nenin 24 të LPP-së pasi që gjatë administrimit me këtë procedurë të prokurimit ka lejuar Zyrtarin Kryesor të Prokurimit të veproj në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë që i takojnë me kontratën e punës dhe ligjin e prokurimit. Sipas pikës 2 të këtij neni, AK është i obliguar të administroj me procedurën e prokurimit në përputhje të plotë me ligjin e prokurimit dhe në të kundërtën duhet të e njoftoj KRPP-në në rast se Zyrtari Kryesor i Prokurimit iu shmanget obligimeve dhe përgjegjësive që ia ka dhënë ligji i Prokurimit Publik. Ja si e përshkruajnë neni 24.2 dhe 24.3 i LPP-së këtë obligim të AK-së:

24.2 Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj.
24.3 Zyrtari i Prokurimit i një autoriteti kontraktues është përgjegjës që menjëherë t'i raportojë KRPP-së mbi aktivitetet e prokurimit të autoritetit përkatës kontraktues që ekzekutohen në një mënyrë që nuk është në pajtim me këtë ligj.

Bazuar në këtë shihet hapur se AK gjatë administrimit të procedurës dhe gjatë procesit të vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderuesve, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 24 të LPP-së dhe në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit mbi administrimin e procedurave të prokurimit vetëm sipas ligjit të prokurimit publik.

Pretendimi 4: AK ka shkelur nenin 52 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit, krahasimit dhe **sqarimit** të tenderuesit që e ka shpallur fitues ka pranuar dëshmi dhe dokumente shtesë që nuk janë të lejueshme dhe nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara me dosjen e tenderit. Veprimi i tillë e shtynë AK-në drejt shkeljes së pikës 7 të këtij nenin sepse edhe përkundër asaj që OE ka dështuar të sjellë dëshmitë dhe dokumentet adekuate me rastin e kërkesës për sqarim, AK prapë e ka konsideruar si të përgjegjshëm dhe e ka shpallur pa të drejtë fitues të tenderit. Kjo tregon hapur se AK ka vepruar në kundërshtim me vlerësimin e drejtë të OE ku rrjedhimisht ka shkelur plotësisht edhe nenin 52 të LPP-së.

Pretendimi 5: AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit të publikuar për këtë qëllim. Pika 4 e këtij neni shumë qarë e thotë se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ky nen konsiderojmë se është shkelur me rastin e vlerësimit, sqarimit dhe krahasimit të tenderëve e posaçërisht të OE që e ka shpallur fitues.

Në vazhdim po e paraqesim secilën mangësi që OE i shpallur fitues e posedon në tenderin e tij si dhe do të argumentojmë që disa nga dëshmitë që AK i ka pranuar si të rregullta, **nuk** janë sipas ligjit dhe **nuk** e plotësojnë kushtin e kërkuar nga AK përmes dosjes së tenderit.

- Kërkesa për posedimin e një Inxhinieri të Hidroteknikës ishte e parashtruar kështu:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale		**Operatori ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme:** **- Një inxhinier i diplomuar ose bachelor i hidroteknikes, së paku me tre vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjajshme**	**Për të gjithë personelin profesional CV-të, diploma, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për stafin.**

OE ka paraqitur si dëshmi jo të rregullta për këtë inxhinier ku shihet qartë se CV-ja nuk është e nënshkruar nga vet inxhinieri edhe pse e posedon vendin e paraparë për këtë qëllim. Ja dëshmia:

B I O G R A F I

1 Emri: NASER Mbiemri: KAJTAZI
2 Data e lindjes: 15 / 12 / 1961
3 Gjendja martesore: i martuar
4 Adresa: Rr. "Hakif Zejnullahu" , PODUJEVË
5 Nr. Tel. (+) 37744241493
6 Vendëlindja : fshati PAKASHTICË E EPËRME ; Komuna : PODUJEVË
7 Arsimimi:
Shkolla e mesme e kryer prej : 1972 deri 1980

INXHINIER PËRGJEGJES NË NJËSINË OPERATIVE TË OJESJELLESIT NË PODUJEVË

me 07 / 06 / 2016
PODUJEVË

NASER KAJTAZI ing.dipl.ndërtim.

Kjo CV dyshohet se është fiktive dhe vetëm se iu është marrë personit në fjalë nga ndonjë projekt i mëhershëm sepse shihet që posedon datën shumë të hershme dhe se nuk është fare e nënshkruar nga vet personi. Si e tillë kjo dëshmi është e papranueshme dhe flitet që ky dokument është futur në dosjen e tenderit pa konfirmimin paraprak të tij. Këtë e dëshmon edhe fakti se ky person punon

me orar të rregullte në KURP SH.A., ku brenda viti posedon vetëm 20 ditë pushim dhe se e ka të pamundur ta përcjell projektin ashtu siç kërkohet me planin e realizimit nga AK.
Mangësi tjetër tek ky Inxhinier është se në CV ka paraqitur se ka punuar në disa kompani dhe institucione dhe se aktualisht punon në KRUP SH.A. por që ka dështuar të paraqes një referencë për realizim të ndonjë kontrate të ngjashme sipas vendeve të punës të dhëna në CV. Pas kërkesës për sqarim që të sjellë një dëshmi/referencë lidhur me ndonjërin angazhimet e paraqitura në CV, OE e sjellë një referencë nga një kompani dhe projekt tjetër që nuk figuron fare në CV. Me që CV për inxhinierin konsiderohet edhe si listë e projekteve për projektet e realizuara nga Inxhinieri atëherë asnjë dëshmi jashtë kësaj liste **nuk** mund të pranohet me rastin e sqarimit/kërkimit të dokumenteve shtesë. Me që projekti dhe kompania që e kanë lëshuar këtë referencë nuk ndodhen si informatë në CV të këtij inxhinieri tregon edhe për një arsye shtesë që kjo referencë nuk mundet të pranohet si dokument shtesë. Ja si e përshkruan rregullorja këtë veprim:

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

dhe

39.3 Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues **gjatë vlerësimit** të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.

Në asnjë rrethanë nuk mundet të verifikohet objektivisht se gjendja e tillë ka ekzistua edhe para hapjes publike kur vet inxhinieri në CV nuk e ka potencuar se ka punuar për kompaninë nga e cila më pas e ka sjellur referencën dhe se në kohën kur pretendohet se ka menaxhuar punimet e tilla të projektit në fjalë ka thënë se ka qenë duke punuar tek KURP SH.A.
AK këtu ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 72 të LPP-së dhe nenin 39 të RRUOPP-së. Ja si duket referenca e tillë e dorëzuar nga OE pas kërkesës për sqarim:

LETËR REFERENCË

Per ing.hidro. Naser kajtazin

Me kete document deshmojme qe z. Naser Kajtazi I lindur me date: 15.12.1961 i angazhuar ne kompanine tone " PARTNER & DERVISHOLLI ING" sh.p.k Prishtine, ka qene menagjer I hidro instalimeve ne projektin:

Ndertimi I objektit "Residio IV" Perkatesisht lameles "A" me etazhitet -3B+S+P+8 ne periudhen 01.02.2017 deri me 30.03.2018

I njejti ka perfunduar dhe menagjuar me sukses kontraten e specifikuara me larte.

Naseri ka qen nje model I nje punetori te mire, I besueshem dhe me etike profesionale.

" PARTNER & DERVISHOLLI ING" sh.p.k

PARTNER DERVISHOLLI ING PRISHTINE

Kjo dëshmi është fiktive dhe e papranueshme pasi që përpos që nuk ekziston si projekt në CV të këtij inxhinieri, dihet se ky inxhinier nuk ka qenë fare i angazhuar në këtë projekt. Ne kompanitë ndërtuese njihemi të gjithë në mes veti dhe me që numri i inxhinierëve të tillë është pak sa i kufizuar, kemi informacione të sakta se kush inxhinier ku ka qenë apo është i angazhuar. Sipas CV-së ky inxhinier në kohën kur është realizuar projekti si në referencë ka qenë punëtor i rregullte në KRUP SH.A. dhe se **nuk** ka pasur të drejtë e as mundësi të përcjellë një projekt të tillë tek kompania që e ka lëshuar referencën. Ky dokument dyshohet të jetë fiktiv dhe i pa bazuar në rrethanat reale të realizimit të projektit për çka edhe është lëshuar referenca. Këto dokumente fiktive ne do ti paraqesim edhe tek organet kompetente sepse përmes tyre po tentohet të manipulohet sistemi i prokurimit dhe dëmtimi i buxhetit të komunës.
Bazuar në nenin 3 të marrëveshjes në mes OE dhe Inxhinierit shihet se në asnjë rrethanë ky inxhinier nuk ka mundësi të mbikëqyrë punimet si i punësuar i rregullte në një ndërmarrje publike me orar të rregullte. Orari i punimeve sipas kontratave të stafit tjetër të këtij OE shihet se është 8.00 deri 16.30 andaj si ka mundësi të mbikëqyren punimet nga inxhinieri i tillë kur nga ora 8.00-16.00 ndodhet me punë të rregullte tek KRUP SH.A.. Ja dëshmi e orarit të punës tek OE i shpallur fitues:

Numri i Prokurimit: 615-22-363-5-2-1

– **Titulli:** Ndërtimi i shkollës në fshatin Obrançë
(Përshkrimi i shkurtër i detyrave te punës apo shërbimeve)
(Brief description of work tasks or services)

2, Vendi i punës/Working place **Komuna Podujeves**

(Selia/Headquarters)

3,Orari i punës/Hours **8 orë/ 8 hours**

8-16^{30}

Për këtë element ne do të konsultohemi edhe me ndërmarrjen KRUP SH.A. dhe se do të njoftojmë për shkeljet që ky person shkakton me rastin e angazhimit pa të drejt në dy kompani me të njëjtin orar të punës. Kjo është e ndaluar me rregulloren e punës së KRUP SH.A. si dhe me ligjin mbi tatimin në të ardhurat të Administratës Tatimore të Kosovës dhe se i njëjti nuk mundet të operoj edhe në një kompani tjetër për çka AK u deshtë mos me pranua si dëshmi dhe staf të rregullte të OE që e ka shpallur fitues.

- OE i shpallur fitues nuk ka ofruar fillimisht në tenderin e tij as referencat e 20 të punësuarve siç ishte kërkuar në dosjen e tenderit.

Me rastin e kërkesës për sqarim nga AK, OE në fjalë ka ofruar referenca fiktive të këtij stafi ku referenca e njëjtë me të dhëna identike është dorëzuar për të gjithë 20 punëtorët në fjalë. Mjafton të shohësh referencat e tilla dhe do ta kuptoni se bëhet fjalë për dëshmi fiktive të cilave u mungon nënshkrimi dhe si të tilla nuk do duhej të pranohen nga AK. Referencave të tilla u mungon edhe nënshkrimi i e vet personave që janë paraqitur si punëtor. Si ka mundësi që të gjithë punëtorët (*20 persona*) të kenë përgatitje dhe prirje të njëjtë për punë dhe angazhim. Përpos kësaj 5(pesë) nga punëtorët për të cilët janë dorëzuar kontratat dhe CV-së nuk ndodhen fare në listën e punëtorëve, 1(një) punëtor që ndodhet në listë nuk posedon kontratën si dëshmi dhe 7(shtatë) punëtorë nuk posedojnë në kontratat e tyre informatat e nevojshme siç janë numri personal dhe ndonjë informatë

tjetër personale përkatëse. Bazuar në këtë, dëshmitë e tilla janë të papranueshme dhe nuk do duhej konsideruar si kusht i plotësuar nga ana e AK-së.

- AK në dosjen e tenderit tek *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale* kishte kërkuar edhe që OE të jenë të pajisur edhe me mjete pune dhe pajisje për realizim të projektit. Kërkesa e tillë ishte kështu:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale		**Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit**	**Dëshmi Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jenë me afat të regjistrimit), ndërsa pajisjet tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve(faturë, DUD, etj) Vëmendje Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.**

OE i shpallur fitues ka paraqitur listën e pajisjeve të vitit 2018 që do të shfrytëzohen për realizimin e projektit por që dëshmitë mbështetëse nuk janë në rregull dhe nuk e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit. Kjo listë nuk korrespondon me dëshmitë mbështetëse të ofruar mbi pronësinë, të drejtën e shfrytëzimit dhe regjistrimin e tyre. Mjetet të cilat nuk posedojnë fare librezë regjistrimi e që figurojnë në listën e pajisjeve janë:

1.Mercedes kipper 25-35 Viti 1989 cope 2 , nuk posedon libreze regjistrimi.
2.Mercedes 60S D Viti 1990 cope 1 , nuk posedon libreze regjistrimi.
3.Kombi Vollsvagen 1989 cope 1, nuk posedon libreze regjistrimi.
4.Mixer Mercedes 33-36 kap. 8m3 Viti 1989 , nuk posedon libreze regjistrimi.
5.Veture Peugeot 2003 cope 1 nuk posedon libreze regjistrimi.
6.Veture Audi 2006 cope 1 nuk posedon libreze regjistrimi.
7.Fiat tip 79-12 kiper cope 1, nuk posedon libreze regjistrimi.

Librezat të cilat nuk gjenden në listën e pajisjeve.

1. Renault Master Viti 1997, nuk gjendet ne listën e pajisjeve.
2. Volkswagen-VW Viti 2000, nuk gjendet ne listën e pajisjeve
3. Mercedes 3336 8x4 Viti 2000, nuk gjendet ne listën e pajisjeve.
4. Iveco 79.14.1-B Viti 1987, nuk gjendet ne listën e pajisjeve.
5. Eskavator Libherr Tipi A900 Viti 1992, nuk gjendet ne listën e pajisjeve.

Përpos këtyre ka edhe pajisje tjera që nuk mund të identifikohen dhe nuk gjenden fare në listë si dhe pajisje që janë në listë dhe nuk posedojnë dëshmi të pronësisë apo të drejtës për shfrytëzim(*fatura apo DUD-a*).
Sipas kësaj shihet qartë se ky OE nuk e ka plotësuar kushtin e kërkuar nga AK tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale për stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit dhe për këtë mangësi AK është dashur ta konsideroj si OE të papërgjegjshëm.

- OE në fjalë nuk ka dorëzuar tek tenderi i tij as Aneksin 1 të dosjes së tenderit mbi specifikimin teknik dhe se nuk ka dorëzuar as deklaratë mbi realizimin e projektit sipas specifikimeve teknike dhe projektit të paraparë nga AK.

Sipas ligjit dhe rregullores së prokurimit, ky dokument është mandator për dorëzim në çdo procedurë të prokurimit. Ja si e përshkruan rregullorja e prokurimit këtë veprim:

Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu (“**specifikimit teknik**” – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene ne përputhje me specifikimin e kërkuar)	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	28

Me që tenderi i OE bëhet pjesë e kontratës dhe mbi bazën e sajë edhe realizohet projekti, tregon se mungesa e specifikimit teknik ose mungesa e deklaratës mbi realizimin e projektit sipas specifikimeve teknike përbënë një rrezik për menaxhimin e mirëfilltë të projektin dhe rrezikon keqpërdorimin buxhetit të komunës. Për këtë mangësi OE i tillë konsiderohet i papërgjegjshëm dhe si të tillë AK është dashur ta eliminoj nga konkurrenca.

- AK ka kërkuar që sigurimi i tenderit të ketë validitetin prej 90 ditëve. OE “Konstruktori Ing.1969 Sh.p.k.”, ka paraqitur sigurimin e tenderit me validitet nga 18.02.2022 deri më 18.05.2022 e që realisht janë 89 ditë. Kushti i kërkuar nga AK që sigurimi i tenderit të jetë 90 ditë nuk është plotësuar dhe tenderuesi në fjalë do duhej konsideruar i papërgjegjshëm.

Ja dëshmia:


Kjo garanci është e vlefshme prej datës 18.02.2022 deri më 18.05.2022

Lëshuar në PRISHTINE datë 18.02.2022

Primi € 125.00 Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

5448

Pas gjithë këtyre sqarimeve të ofruar shihet qartë se AK ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së i cili ka të bëj me vlerësimin, krahasimin dhe sqarimin e tenderëve vetëm sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Pretendimi 6: AK ka shkelur nenin 39 të RRUOPP-së sepse me rastin e sqarimit të tenderit që e ka shpallur fitues ka vepruar në kundërshtim të plotë me pikën 3 të këtij nenin dh enë kundërshtim edhe me tabelën këshilluese mbi veprimin në rastet e bazuar gjatë vlerësimit që ndodhet brenda nenin 39 të RRUOPP-së. Përpos kësaj AK ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së sepse gjatë sqarimit të tenderit në fjalë ka pranuar dëshmi objektivisht të paverifikueshme se gjendja e tillë ka ekzistuar para hapjes publike. Veprimet e tilla janë të ndaluar, favorizuare dhe të dëmshme për vlerësimin e drejtë dhe të mirëfilltë te tenderëve. Si rrjedhim i kësaj konstatojmë se AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së dhe 39 të RRUOPP-së.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdese ankesën tonë dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar, duke marrë:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE **"ARAD 94 SH.P.K."** lidhur me tenderin "**Ndërtimi i shkollës në fshatin Obrançë**" i iniciuar dhe administruar nga **KOMUNA E PODUJEVËS.**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - **KOMUNA E PODUJEVËS** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim.**

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar ne kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së e që realisht më pas do duhej që Fitues të shpallej OE **"ARAD 94 SH.P.K."**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë në aspektin teknik. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, me një përvojë të madhe në këtë fushën e ndërtimeve dhe projekteve të tilla.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- 1 Njoftim per Kontrat
- 2 Template per Dosja e Tenderit - Gjuhe Shqipe
- 3 Paramasa-dhe-Parallogaria Shkolla Obrançë
- 4 KËRKESA PËR INFORMACIONE SHTESË NGA OE
- 5 raport i hapjes se tenderit
- 7 Njoftimi mbi vendimin e AK
- 6 Raporti i vlerësimit 15.04.2022
- 8 Kërkesë për rishqyrtim - ARAD 94 SHPK
- 9 Vendim pezullimi
- 10 Vendim mbi kerkesen per rishqyrtim
- Oferta ARAD 94 SHPK
- Oferta e Konstruktorit dhe sqarimet

Vërejtje: *Të gjitha pretendimet tona mbështeten me fakte që i gjeni të bashkangjitura kësaj kërkesë por e dhe në dokumentacionin e AK*